



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

NR. 194, DATË 24.11.2017

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “SIMA-COM” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-: “MESHURDH” ME FUQI
TË INSTALUAR 1.3 MW.**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma ”a” të Ligjit nr.43/2015, ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 5, gërma ” a”; 13 dhe 21 të ”Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të ”Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e Shoqërisë “SIMA-COM” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Meshurdh” me fuqi të instaluar 1.3MW;

Konstatoi se :

- Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 171 datë 26.10.2017 vendosi: Fillimin e procedurave për licensimin e shoqërisë “SIMA-COM” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Meshurdh”.
- Në vendimin sipërcituar është konstatuar dhe lënë detyrë për aplikuesin që për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me një diagramë elektrike në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes, t’a paraqesë atë në ERE, brenda afateve të përcaktuara.
- Shoqëria “SIMA-COM” sh.p.k., brenda afatit të përcaktuar në rregullore rezultoi se plotëson tërërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016 si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat ” a”, ” b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat ” a”, ” b”, ” c”, “d”, ” e”, ” f” dhe ” g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat ” a”, ” b”, “c” dhe ”d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni tekniko - ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “SIMA-COM” sh.p.k., në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga nga HEC “Meshurdh” me fuqi të instaluar 1.3 MW për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi, mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve nga botimi ne Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

Votimi i Antarëve të Bordit të ERE për,

VENDIMIN

NR. 194, DATË 24.11.2017

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “SIMA-COM” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA NGA HEC-: “MESHURDH” ME
FUQI TË INSTALUAR 1.3 MW.

Antarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

Adriatik Bego

Abaz Aliko

Entela Shehaj

Maksim Shuli
